



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-572-2013 dt. 24 tetor 2013 për lëshimin e Autorizimit final për shoqërinë "Eurokos" JH sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC "Brodi II" (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për HC "Brodi II" (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë), të datës 26.01.2015 të shoqërisë "Eurokos" JH, sh.p.k., me adresë: rruga "Zenun Beqa", nr. 20 – 70000, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Eurokos" JH sh.p.k. dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC "Brodi II" (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC "Restelica I" dhe HC "Restelica II" (Krushevë) që bashkohen në një objekt të hidrocentralit me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.



Arsyetim

- ZRRE me datë 26.01.2015 nga shoqëria **“Eurokos” JH sh.p.k.**, ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC “Brodi II” (Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në lumin Brod dhe HC “Restelica I” dhe HC “Restelica II” (Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.
 - Bordi i ZRRE-së me datë 24 tetor 2013, shoqërisë **“Eurokos” JH sh.p.k.**, i ka lëshuar Vendimin V-572-2013 për Autorizimin final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-572-2013 dt. 24 tetor 2013 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën është lëshuar Autorizimi final shoqërisë **“Eurokos” JH sh.p.k.**, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar